



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

|                      |                                                                                                                                                                                                          |                  |
|----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Për:                 | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit<br>Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit                                                                                        |                  |
| Kopje:               | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së                                                                   |                  |
| Nga:                 | Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL                                                                                                                                                         | Datë: 16.06.2020 |
| Zyrtarët përgjegjës: | Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | Nr.020-343/3     |
| Lënda:               | Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit                                                                                                                                   |                  |
| Lloji i aktit:       | Akt i Kuvendit të Komunës                                                                                                                                                                                |                  |

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Statutin Nr. 12-030-16596 e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala" në Glllogoc, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health**  
**Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Department**

|                                            |                                                                                                                                                                                                        |                  |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| <b>Për:</b>                                | Goran Rakiq-zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Pushtetit Lokal<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave, MAPL |                  |
| <b>Kopje:</b>                              | Kryetari i Komunës së Glogocit                                                                                                                                                                         |                  |
| <b>Përmes:</b>                             | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Z.Armen Zëmaj, Ministër i Shëndetësisë<br>Dr.Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në MSH                                                            |                  |
| <b>Nga:</b>                                | Aferdita Hoxha, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor                                                                                                                                                   |                  |
| <b>Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor</b> | Mirvete Kelmendi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, të mbështetjes ligjore dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e legjislacionit                       | Data: 11.06.2020 |
| <b>Lënda:</b>                              | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit                                                                                                                                              |                  |
| <b>Lloji i Aktit:</b>                      | Akti i Kuvendit të Komunës Glogoc                                                                                                                                                                      |                  |

I nderuari Ministër,  
E nderuara Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Statutin Nr.12-030-16596 të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr.Hafir Shala” në Glllogoc.

I miratuar me 27/05/2020.

I dërguar për shqyrtim në MSh, me datë: 05/06/2020

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionit në fuqi me Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L 125, Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të dërguar për miratim nga Ministri i Shëndetësisë për Drejtorët e Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Udhëzimin Administrativ Nr.08/2017 „Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH).

Pajtueshmëri me aktin e komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë është si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës                                                                    | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në pajtueshmëri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Statuti Nr.12-030-16596 i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr.Hafir Shala” në Glllogoc. | <p>Ligji për Shëndetësi nr. 04/L 125, neni 8 dhe 18 përcakton se politikat shëndetësore hartohen nga Ministria e Shëndetësisë përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë si institucion përgjegjës në fushën e shëndetësisë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr.Hafir Shala” në Glllogoc i miratuar më dt.27.05.2020 dhe ka konsideruar se është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, Statutin si formë unike dhe Udhëzimin Administrativ nr.08/2017, Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH).</p> <p>Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Statutin –akt unik për të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës, i cili unifikon Organizimin dhe</p> |

|  |  |                                                                                                                                                                                                              |
|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  | Veprimtarinë e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, si institucione themelore të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe çfarëdo plotësimi apo ndryshimi në këtë statut, duhet të merr aprovimin e Ministrisë. |
|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

|                       |       |        |       |
|-----------------------|-------|--------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS   |       |        |       |
| KOMUNA GILLOQOC       |       |        |       |
| GILLOQOC MUNICIPALITY |       |        |       |
| Pranuar               |       | 27.05  | 2020  |
| Nj. Org.              | Numër | Shitja | Vlera |
| 12-                   | 030-  | 16596  |       |



**Republika e Kosovës**  
**Komuna e Drenasit**  
**Kuvendi i Komunës**



## **S T A T U T I**

### **I**

**QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "DR. HAFIR SHALA" NË  
DRENAS**

**Maj, 2020**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, 12, paragrafi 12.2, pika d, dispozitave të nenit 17, paragrafi 17.1, pika j të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/2008), dispozitave të nenit 18, paragrafi 3, në lidhje me nenin 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, Udhëzimit Administrativ 08/2017 të Ministrisë së Shëndetësisë për organizimin, strukturën, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), dispozitave të nenit 34, pika 34.6 nën-pika f, të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008, **Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.05.2020, miratoi:**

## **STATUTIN**

### **E**

## **QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "DR.HAFIR SHALA" NË DRENAS**

### **Neni 1**

#### **I - Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emertimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithëshme të QKMF, pronësia dhe financimi, mbikëqyrja e brendëshme dhe dispozitat kalimtare e përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësorë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala" -Drenas (në tekstin e mëtejme: QKMF).

### **Neni 2**

#### **Statusi i QKMF**

1. QKMF ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejme: KPSH).
2. Themelues i QKMF është Kuvendi i Komunës Drenas.
3. QKMF-ja në Drenas ka filluar punën me 1959, fillimisht si "Shtëpi e Shëndetit".

#### **II - Emërtimi dhe Selia**

### **Neni 3**

#### **Emërtimi**

1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr Hafir Shala" në Drenas.
2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF-të në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi Komunës, në bazë të procedurave ligjore.
3. Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të objektit në të cilin kryhet veprimtaria shëndetësore dhe edukative, në gjuhët zyrtare në Kosovë.
4. Për ndryshimin e selisë së QKMF vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e QKMF në Drenas gjendet në rrugën "Xhevat Demaku" Nr. 74 në Drenas.

### **Neni 5**

#### **Vula**

1. QKMF posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Drenas.
2. Vula ka formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm).
  - 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
  - 2.2. Rrethi i dytë: Komuna Drenas-it;
  - 2.3. Rrethi i tretë: QKMF në Drenas;
  - 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës.
3. QKMF posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x3 cm. që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentimit.
4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët, të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë.
5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori.
6. Çdo vulë ka numër identifikues.

### **III - Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF**

### **Neni 6**

#### **Veprimtaria**

1. Veprimtaria e QKMF përfshinë ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Drenasit t'u ofrojë shërbime shëndetësore cilësore, të qasëshme, gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsultantë në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas strategjisë së KPSH dhe standarteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare përbëhet nga një (1) mjekë familjar dhe dy (2) infermierë familjarë që ofrojnë shërbime shëndetësore për 2000 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF (zonimi).
4. Kujdesi Parësor Shëndetësor përfshinë:
  - 4.1. Promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
  - 4.2. Mbrojtjen parandaluese përmes programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore e mesme e ultë (SHFMU), shkolla mesme – e profesionale në territorin e komunës;
  - 4.3. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksinë, vaksino-profilaksinë dhe kemio-profilaksinë në pajtim me ligjin si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësorë të popullatës;
  - 4.4. Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;
  - 4.5. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i tuberkulozës;
  - 4.6. Organizimi i shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore si pjesë e sistemit unik si pjesë e shërbimeve në të tri nivelet e kujdesit shëndetësorë;
  - 4.7. Shërbimet e kujdesit shëndetësorë për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjarë;
  - 4.8. Shërbimet e shëndetit mendor.
5. Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
6. Shërbimet shëndetësore në QKMF Drenas sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për Shëndetësi:
  - 6.1. Specialist në Mjekësinë Familjare;
  - 6.2. Doktor i Mjekësisë;
  - 6.3. Doktor i Stomatologjisë;
  - 6.4. Farmacist i diplomuar – Magjistër farmacistë;
  - 6.5. Specialist i Biokimisë Klinike;
  - 6.6. Infermiere i/e diplomuar;
  - 6.7. Mami e diplomuar;
  - 6.8. Teknik laborant;
  - 6.9. Teknik i radiologjisë në Kabinetin e Radiologjisë;

- 6.10. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë;
- 6.11. Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve nga neni 78 i Ligjit për Shëndetësi.
7. QKMF – Drenas ka edhe Departamentin e Matemitetit në të cilin punon Gjinekologu dhe pjesë përbërëse e këtij departamenti do të jenë edhe Pediatrat.
8. Në KPSH nuk lejohet të bëhet pranimi i specialistëve nga lëmitë tjera. Specialistët ekzistues nga lëmitë tjera, që tani gjenden në KPSH do të vazhdojnë punën në këto institucione si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.

## **Neni 7**

### **Shërbimet**

1. QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:
  - 1.1. Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin;
  - 1.2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
  - 1.3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
  - 1.4. Shërbimet e kujdesit akut-emergjent dhe urgjent;
  - 1.5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;
  - 1.6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë;
  - 1.7. Shërbimet e planifikimit familjarë;
  - 1.8. Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe postnatal;
  - 1.9. Shërbimet e shëndetit oral parandalues;
  - 1.10. Shërbimet e shëndetit mendor;
  - 1.11. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij terminal/palativ;
  - 1.12. Shpërndarja e barërave nga lista esenciale.

## **Neni 8**

### **Përfaqësimi**

1. QKMF në Drenas është institucioni, i cili bënë pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësorë, publike të Ministrisë së Shëndetësisë.
2. QKMF kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi.
3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe paisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF-së dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi.

4. Drejtori i QKMF-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF me pëlqim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

#### **IV. Struktura e Institucionit dhe Sistemi i Informimit në QKMF**

##### **Neni 9**

##### **Organizimi i QKMF-së**

1. QKMF me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:
  - 1.1. Departamenti i Mjekësisë Familjare,
    - 1.1.1. Sektori i Mjekësisë Familjare,
    - 1.1.2. Njësia e SISH,
    - 1.1.3. Njësia e Vaksinimit dhe imunizimit,
    - 1.1.4. Sektori i Shëndetit Oral parandalues,
    - 1.1.5. Sektori i Kujdesit akut-emergjent dhe urgjent,
    - 1.1.6. Sektori i Diagnostikës,
    - 1.1.7. Kabineti Radiologjik,
    - 1.1.8. Laboratori,
2. Departamenti i Administratës së QKMF -Drenas organizohet në:
  - 2.1. Njësia ose Zyra e Personelit,
  - 2.2. Njësia ose Zyra Juridike,
  - 2.3. Njësia ose Zyra për buxhet, financa dhe prokurim,
  - 2.4. Njësia ose Zyra për shërbimet teknike
3. Dep. - Barnatorja Qendrore;
  - 3.1. Barnatorja është njësi organizative e QKMF-së e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike;
  - 3.2. Në barnatore pranë QKMF-së mund të shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike, nga Mjekët Familjarë.
  - 3.3. Çdo tregtim me barna komerciale në barnatore brenda QKMF-së është i ndaluar dhe sanksionohet sipas ligjeve në fuqi.
  - 3.4. Me barnatore udhëheq Shefi i Barnatores (Mr.Ph.)

4. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Ligji për Shëndetësi në QKMF-Drenas, funksionon edhe Programi i Trajnimit të Mjekësisë Familjare ku këtu përfshihet EVP (Edukimi i Vazhdueshëm Profesional) për mjek dhe infermier si dhe trajnimet e domosdoshme jashtë institucionit tonë.
5. Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF – Drenas, Komoran, Tërstenik, Baicë, Arllat, Gllanasellë) dhe Ambulancat e Mjekësisë familjare (AMF-Nekoc, Sankoc, Poklek-Vasilevë, Gradicë, Abri, Tërdec dhe Dobroshec), janë në kuadër të QKMF-së në Drenas dhe përbëjnë Rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Drenasit.
6. Rrjeti i Institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5 do të jenë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga K.Komunës së Drenasit me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.

#### **Neni 10**

#### **Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF**

1. QKMF në Drenas zbaton sistemin unik të informimit Shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.
2. Për qëllime të Sistemit të Informimit Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-DSHMS dhe QKMF, do të zhvillojnë një sistem unik të kodeve për të gjitha QKMF-të dhe departamentet e saj.
3. QKMF bënë mbledhjen, evidentimin, vendosjen e të dhënave statistikore në Shërbimin e Informimit Shëndetësor-SISH dhe WEB aplikacion, në programin kompjuterik të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili përmbanë të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.
4. Çdo profesionist shëndetësor, gjatë raportimit duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale duke mos i cenuar të drejtat e pacientit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.
5. Sistemin e Informimit Shëndetësorë në QKMF e përbëjnë:
  - 5.1. Sistemi i evidencave me të cilin rregullohet evidentimi i të dhënave;
  - 5.2. Sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësishtë grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre dhe publikimi i tyre.

## **V. Udhëheqja dhe trupat e QKMF-së**

### **Neni 11**

#### **Këshilli Drejtues, Struktura**

1. Këshilli Drejtues ka 5 anëtarë:
  - 1.1. Drejtori i QKMF-së, i cili e kryeson Këshillin;
  - 1.2. Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;
  - 1.3. Kryeinfurmjerja/ri i QKMF-së;
  - 1.4. Udhëheqësi i Departamentit të Administratës;
  - 1.5. Kordinatori për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjatë sa edhe kontratat e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë, në rastet kur:
  - 2.1. Anëtari ndërprente marrëdhënien e punës në QKMF,
  - 2.2. Anëtari i Këshillit Drejtues jep dorëheqje;
  - 2.3. Anëtari i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit brenda vitit, tri herë radhazi.
  - 2.4. Anëtari nuk respekton detyrat e punës.

### **Neni 12**

#### **Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit**

##### **Drejtues**

1. Këshilli Drejtues kryen detyrat e përcaktuara me këtë Statut dhe vendosë për:
  - 1.1. Veprimtarinë e QKMF-së dhe vërteton politikën punuese të QKMF-së;
  - 1.2. Propozon ndryshimet e Statutit të QKMF-së, të cilat i aprovon K.K.Drenasit dhe Ministria e Shëndetësisë;
  - 1.3. Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF në Divizionin e Kujdesit Parësor në Ministrinë e Shëndetësisë përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.
  - 1.4. Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;
  - 1.5. Përgatitë programin e punës dhe planin financiar;
  - 1.6. Nxjerr rregulloren për organizimin e punës në QKMF dhe akte tjera në përputhje me politikat e MSh, ligjin dhe me këtë Statut;
  - 1.7. Harton planin e burimeve njerezore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e MSh;
  - 1.8. Harton planin e furnizimit të QKMF-së dhe vendos për dhënjën në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënien në shfrytëzim të mjeteve të veqanta pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë.

- 1.9. Harton planin mbi ZhVP në përputhje me Planin Nacional të ZhVP të kuadrit mjekësor dhe siguron aplikimin-implementimin e tij;
- 1.10. Bënë planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë;
- 1.11. Vendos për mbarëvajtjen e punëve;
- 1.12. Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese;
- 1.13. Vendos për sigurimin e pasurisë së QKMF-së, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;
- 1.14. Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të MSh;
- 1.15. Shqyrton njoftimet mbi mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme mbi punën profesionale.
- 1.16. Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF-së;
2. Këshilli Drejtues i QKMF i kryen detyrat brenda përgjegjësi të veta në takime;
3. Këshilli Drejtues mban takime të rregullta në të cilat marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve;
4. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të votave të anëtarëve të zgjedhur;
5. Në takimet e Këshillit Drejtues mbahet procesverbal, të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në takimin vijues.

### **Neni 13**

#### **Drejtori i QKMF**

1. QKMF-në e udhëheqë Drejtori i QKMF-së;
2. Drejtori përfaqëson, prezanton QKMF-në dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës.

3. Drejtori i QKMF-së i përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ e financiar si dhe të gjitha funksionet që lidhen me shërbimet në QKMF, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

#### **Neni 14**

##### **Procedura për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit**

1. Drejtori i QKMF zgjedhet në përputhje me Legjislacionin në fuqi i cili i rregullon procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me konkurs publik të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Drejtorin e zgjedh Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – DSHMS.
3. Drejtor i QKMF duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi (kualifikime, përvojë e kapacitete menaxheriale):
  - 3.1. Të jetë Mjek specialist nga Mjekësia Familjare;
  - 3.2. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional ose trajnime në fushën e menaxhimit shëndetësor;
  - 3.3. Kandidati për Drejtor duhet t'i ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale.
4. Vendimin për publikimin e konkursit për Drejtor të QKMF e merr DSHMS.

#### **Neni 15**

##### **Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të QKMF**

1. Drejtori i QKMF është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF si dhe për punën profesionale të QKMF e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, dhe akteve të tjera normative.
2. Drejtori i QKMF është përgjegjës për përkujdesjen efikase dhe efektive të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të gjithë banorët e Komunës së Drenasit dhe përgjigjet për detyrat që vijnë:
  - 2.1. Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Drejtori i QKMF i propozon për miratim DShMS Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF për vitin vijues;
  - 2.2. Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore;

- 2.3. Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e DShMS zbaton buxhetin e QKMF-së;
- 2.4. Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
- 2.5. Avancoon punën ekipore;
- 2.6. Mundëson Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF;
- 2.7. Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë;
- 2.8. Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së;
- 2.9. Identifikon partnerët dhe zhvillon marrëdhënie me donatorët, Organizatat Jo-Qeveritare;
3. Programi i Punës së QKMF-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga MSH.
4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF si:
  - 4.1. Plani vjetor i punës;
  - 4.2. Organizimi dhe udhëheqja;
  - 4.3. Burimet njerëzore;
  - 4.4. Plani financiar;
  - 4.5. Raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare;
5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF i përgjigjet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

#### **Neni 16**

1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të tërheqë vëmendjen:
  - 1.1. Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF;
  - 1.2. Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin (Planin Komunal Zhvillimit të Institucioneve KPSH) e punës së QKMF;
  - 1.3. Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

#### **Neni 17**

#### **Trupat e QKMF-së**

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF, formon Trupat Profesional në QKMF, siç janë:
  - 1.1. Këshilli Profesional;
  - 1.2. Komisioni Disiplinor i QKMF-së;
  - 1.3. Komisioni i Ankesave i QKMF-së;
  - 1.4. Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore;
  - 1.5. Komisioni Etiko-Profesional.
2. Anëtarët e trupave profesional emërohen nga Drejtori i QKMF-së;
3. Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF-së, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF.

## **Neni 18**

### **Këshilli Profesional**

1. Këshilli Profesional është trup këshilldhënës i Drejtorit të QKMF-së;
2. Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektoreve dhe Njësive, Shefit të Barnatores si dhe Kryeinfermieri/ja e QKMF-së, sipas nenit 9 të këtij Statuti;
3. Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së;
4. Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.
5. Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:
  - 5.1. Përgatit, thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional;
  - 5.2. Verifikon rendin e ditës së takimeve dhe
  - 5.3. Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.
6. Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërrasë mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF-së.
7. Këshilli Profesional i QKMF-së, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:
  - 7.1. Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale;
  - 7.2. Propozon Këshillit Drejtues dhe Drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
  - 7.3. Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
  - 7.4. Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorve shëndetësor në përsosje profesionale dhe
  - 7.5. Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.

## **Neni 19**

### **Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore**

1. Në QKMF funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;
2. Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të emëruar nga këshilli drejtues;
3. Komitetin për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore e udhëheqë profesionisti Shëndetësor i caktuar nga Drejtori i QKMF-së;
4. Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore është trup i cili mbikëqyrë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore në QKMF përmes kordinatorit të cilësisë.
5. Kordinatori i cilësisë, është profesionisti Shëndetësor i/e trajnuar në standardet e cilësisë, i/e cili rekrutohet sipas legjislacionit në fuqi;
  - 5.1. Hulumtimeve dhe auditeve klinike;
  - 5.2. Organizimit të rishqyrtimeve kolegjiale;
  - 5.3. Mbikëqyrjes së punës profesionale mjekësore të ekipeve të Mjekësisë Familjare;
  - 5.4. Propozimit të masave për përmirësim të gjendjes;

## **Neni 20**

### **Komisioni Etiko - Profesional**

1. Komisioni Etiko-Profesional është trup i cili siguron kryrjen e veprimtarisë së QKMF-së mbi bazat e etikës dhe profesionalizmit shëndetësor.
2. Përbërja dhe kompetenca e Komisionit Etik-Profesional rregullohet me Udhëzimin Administrativ për mbikëqyrjen etike-profesionale.

## **Neni 21**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, nëse ato nuk janë të përcaktuara me ligj.

## **Neni 22**

### **Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional**

1. Në kuadër të QKMF-së organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtorëve shëndetësor, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shëndetësi dhe të akteve të tjera ligjore, nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

2. Aktivitetet e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), të Shkollimit Specialistik Pasdiplomik dhe atij të Edukimit Themelor Profesional (ETHP), për profesionistët shëndetësor në KPSH, organizohet në Qendrën e Zhvillimit të Mjeksisë Familjare të Kosovës ( QZHMFK), në ShSKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në Qendrat për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik (QEVI), në Qendrat e Trajnimit të Mjekësisë Familjare (QTMF) të menaxhuar nga QZHMFK, në bashkëpunim me Asociacionin e Mjekëve Familjarë të Kosovës dhe Asociacionin e Infermierisë së Kosovës.
3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgaditje adekuate akademike dhe profesionale, që caktohet nga Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare e Kosovës dhe Qendra të Edukimit të Vazhdueshëm Infermierik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me QKMF;
4. Financimi i ZHVP të profesionistëve shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.

## **VI. Mbikëqyrja e QKMF**

### **Neni 23**

#### **Llojet e mbikëqyrjes në QKMF**

1. QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Shëndetësi që sigurohet përmes DSHMS-së dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;
2. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e bjen Këshilli Drejtues i QKMF-së;
3. Mbikëqyrja e QKMF-së përfshin:
  - 3.1. Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve.
  - 3.2. Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria;
  - 3.3. Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave në përputhje me rregullat e Prokurimit Publik;

## **VII. Aktet nga veprimtaria e institucionit**

### **Neni 24**

#### **Aktet e përgjithshme**

1. Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF nxjerr këto akte të Përgjithshme:
  - 1.1. Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në përputhje me politikat e MSH dhe aktet normative në fuqi;
  - 1.2. Rregulloren për punë;
  - 1.3. Rregulloren për mbrojtjen në punë;
  - 1.4. Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
  - 1.5. Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
  - 1.6. Rregulloren për rendin shtëpiak;
  - 1.7. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;
  - 1.8. Rregulloren për parandalimin e infeksioneve dhe
  - 1.9. Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF.

### **VIII. Pronësia, Buxheti dhe Financat**

#### **Neni 25**

##### **Pronësia**

1. QKMF ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Kuvendit Komunal.
2. QKMF si institucion i KPSH është përvetësuese e fondit nga Buxheti i Kosovës.
3. Pasurinë e QKMF e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF ka të drejtë të disponojë në pajtim me aktet normative në fuqi.

#### **Neni 26**

##### **Buxheti**

1. Çështja buxhetore dhe financiare e QKMF-së administrohet në mënyrë transparente, në pajtim me rregulloret për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.
2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF-së përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese.
3. Prokurimi i QKMF-së bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhe akteve nën-ligjore.
4. Drejtori mund të kërkojë auditim të jashtëm dhe të monitoriojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

## **Neni 27**

### **Financimi**

1. QKMF shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Buxheti i Komunave dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse.
2. Procedurat dhe forma e bashkëpagesës për shërbimet e ofruara në QKMF përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi.

## **Neni 28**

### **Shtojca**

Aneksi 1 është pjesë përbërse e këtij Statuti (Mbishkrimet, vulat e rrumbullakta dhe vulat katrore të QKMF, QMF dhe AMF) si dhe Skema organizative.

## **IX. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

## **Neni 29**

### **Perioda kalimtare dhe shfuqizimi**

1. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi dhe këtë Statut.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF Nr.02-469, Mars 2006-2008.

## **Neni 30**

Për zbatimin e këtij Statutit kujdeset: Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale dhe QKMF Drenas.

## **Neni 31**

Ky statut hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.



**Kryetari i Kuvendit të Komunës**

**Labinot Halilaj**

*Aneksi 1*



**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

**GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE**

**Mbishkrimi i QKMF**



QENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE

CENTAR PORODIČNE MEDICINE • FAMILY HEALTH CENTRE



Mbishkrimi i QMF (1, 2, 3, ...)



AMBULANTA E MJEKËSISË FAMILJARE

AMBULANTA PORODIČNE MEDICINE • RURAL FAMILY HEALTH CENTRE

Mbishkrimi i AMF



Vula e Rrumbullakët e QKMF



Vula e Rrumbullakët e QMF



Vula e Rrumbullakët e AMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 Komuna e • Opština • Municipality of QKMF • GCPM • MFHC  
 No.: \_\_\_\_\_  
 Datë/Datum/Date: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_  
 Vendi/Mesto/Place: \_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Vula e Katrore e QKMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 Komuna e • Opština • Municipality of QMF • CPM • FIC  
 No.: \_\_\_\_\_  
 Datë/Datum/Date: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_  
 Vendi/Mesto/Place: \_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Vula e Katrore e QMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 Komuna e • Opština • Municipality of AMF • APM • RFHC  
 No.: \_\_\_\_\_  
 Datë/Datum/Date: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_  
 Vendi/Mesto/Place: \_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Vula e Katrore e AMF